RAPORT I AKTIVITETEVE TË XHAMISË TRETË SARAJ

Raport i tërësishëm i aktiviteteve dhe veprimtarisë në Xhaminë e Tretë në Saraj, që nga fillimi i ndërtimit në vitin 2006 e deri në përfundim të vitit 2019.

Përgatiti: Hoxha Shaban Tairi

وَقُلِ اعْمَلُوا فَسَيَرَى اللَّهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ وَالْمُؤْمِنُونَ وَسَتُرَدُّونَ إِلَى عَالِمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

"Dhe thuaj: Punoni, e punën tuaj do t`a shoh Allahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët, e pastaj do të ktheheni te Njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t`ju njoftojë me atë që keni punuar"

= Teube, 105 =

Të ndërtosh një xhami dhe t`i shërbesh asaj, është një cilësi e besimtarëve të sinqertë dhe të devotshëm, të cilët mundohen të ofrojnë mundësi besimtarëve tjerë që të kenë një vend ku do të adhurojnë Allahun, ku do t`i falen Atij dhe do të përhapin fenë Islame dhe mësimet e saja.

Edhe në lagjen tonë u paraqit nevoja që të ndërtohet një xhami e re, për arsye se besimtarët tanë nuk kishin mundësi të udhëtojnë rregullisht në xhamitë tjera për shkak të largësisë së rrugës, kështu që është bërë një konsultim në të cilin është diskutuar për mundësitë për të blerë një vend ku do të fillohet ndërtimi i xhamisë dhe si do të organizohet puna e ndërtimit të së njëjtës.

Fillimisht është bërë analizimi se cila pjesë e tokës është më e përshtatshme e që do të blehet për të filluar ndërtimin e xhamisë dhe është ardhur në përfundim që të blehet një tokë në vendin e quajtur *Çardak*. Ky vend gjendet në anën e majtë në afërsi të autostradës Shkup-Tetovë. Toka ka qenë pronë e një maqedonasi, i cili është pajtuar që të na shesë vendin për xhami.

Për ndërtimin e xhamisë së tretë në Saraj, formohet edhe një këshill inicues i cili do të udhëheq punën e ndërtimit të xhamisë. Këshilli inicues përbëhej nga Amet Tairi, Sali Ziberi, Nehat Shaipi, Rufat Ademi, Xhemail Ilazi dhe Xhevit Haxhiu. Kjo iniciativë është ndërmarrë me datë 31.05.2004 dhe që nga kjo datë fillon organizimi për ndërtimin e xhamisë. Gjatë një periudhe janë diskutuar mundësitë dhe format e punës, që me 11.04.2006 të mbahet mbledhje për të diskutuar se sa mjete gjenden në posedim. Pasi është vlerësuar se ekzistojnë mjetet e mjaftueshme për fillimin e punës, atëherë nis ndërtimi i xhamisë më 15.08.2006.

Blerja e tokës për ndërtimin e xhamisë ka kushtuar 22.000 euro të cilat janë tubuar nga njerëz dashamirë të fesë.

Brenda disa ditëve, është përgatitur themeli i xhamisë që në mënyrë zyrtare të bëhet edhe gurrthemeli i xhamisë. Me datë 9.09.2006 është hedhur gurrëthemeli i xhamisë, në ceremoninë e së cilës ka qenë prezent edhe myftiu i atëhershëm i Shkupit, mr. Taxhedin Bislimi.

Më pas në mënyrë të vazhdueshme dhe intenzive është vazhduar me punën, ku edhe shumë njerëz në mënyrë vullnetare kanë punuar në ndërtimin e xhamisë.

Ndërtimi i xhamisë ka zgjatur për tri vite të plota, derisa është afruar në fazën përfundimtare për të qenë në shërbim të plotë për kryerjen e adhurimeve.

Të hollat për ndërtimin e xhamisë janë tubuar nëpër njerëz në fshatin Saraj, më pas është parë nevoja që të kërkohet ndihmë edhe nëpër fshatrat tjera, kështu që vullnetarisht këshilli ka dalur në teren për tubimin e ndihmave nëpër xhami të ndryshme të qyteve tjera, nëpër shitore, kompani dhe bëmirës të ndryshëm, të cilët kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm për të realizuar qëllimet e xhamisë.

Ndërtimi i minares së xhamisë është përfunduar me datë 14.03.2008 dhe ka një lartësi prej 46 metra, kurse mjeshtër për ndërtimin e saj ishin Safet dhe Shaban Amiti nga Bukoviqi. Përmasat e xhamisë janë 14x19 metra dhe ka një hapësirë në të cilën mund të falen në mes 200-300 besimtarë.

Kjo është xhamia e 33-të me rradhë që është ndërtuar në Derven të Shkupit.

Me afrimin e muajt të Ramazanit në vitin 2009, besimtarët insistojnë që teravitë e muajit të Ramazanit, t`i falin në xhaminë e re. Dhe kështu u mundësua që xhamia të jetë gati për të pritur besimtarët për të filluar adhurimin në këtë shtëpi të Zotit.

Deri në këtë fazë, për ndërtimin e xhamisë janë shpenzuar mbi 120.000 euro.

Me hapjen e xhamisë, xhemati vendosin që të zgjedhin edhe këshillin e rregullt të xhamisë, ku në mënyrë unanime nga të pranishmit në xhami, vendoset që të bëhet votimi për këshill të xhamisë në përbërje prej: Amet Asani (Muteveli), Amet Tairi (arkatar), Mirsat Loku, Xhevit Haxhiu, Xhelal Aliu dhe Baki Shaqiri.

Në ditën e parë të muajit të Ramazanit më 20.08.2009 fillohet me faljen e namazeve të teravisë në xhaminë e re.

Për të zhvilluar organizimin e fesë në këtë xhami, si për fillim nga myftinia e Shkupit caktohet si ligjërues Miftar Ameti, kurse si imam për faljen e teravive caktohet hoxha Hasretullah Saiti, i cili edhe jeton në afërsi të xhamisë.

Gjatë tërë muajit Ramazan të vitit 2009, në xhami kryhen të gjitha ritualet fetare dhe vazhdohet me aktivitetin e këtyre dy hoxhallarëve deri në përfundim të muajit të Ramazanit.

Gjithësej janë tubuar 43.600 denarë për hoxhallarët të cilat i kanë ndarë në mes tyre. Ndërsa sadakatul fitër për myftininë e Shkupit, janë tubuar 22.150 denarë.

Pas përfundimit të fitër Bajramit, paraqitet nevoja për të zgjedhur për hoxhallarë të rregullt dhe pas një konsultimi në mes këshillit të xhamisë dhe xhematit të rregullt, vendoset për të punësuar dy hoxhallarë njëkohësisht, të cilët do të ndajnë në mes tyre raportet e punës.

Në këtë mbledhje të udhëhequr nga kryetari i xhamisë, vendoset që imam të rregullt të jenë hoxha i lagjes Shaban Tairi dhe hoxha nga Bukoviqi, Zeqirja Tairi.

Ky vendim është marrë më 29.09.2009 e martë. Nga këshilli i xhamisë vendoset që hoxhës Shaban Tairi t`i jepet rrogë mujore prej 8000 denarësh kurse hoxhës Zeqirja Tairi t`i jepet rrogë mujore prej 10.000 denarësh. Namazin e sabahut dhe jacisë e ka pasur për detyrë t`i fal hoxha Shaban, kurse drekën, ikindinë dhe akshamin i ka falur hoxha Zeqirja. Ndërsa detyrat tjera i kanë ndarë në mënyrë proporcionale në mes tyre. Një xhuma ka ligjëruar hoxha Shaban, kurse xhumanë tjetër hoxha Zeqirja. Po ashtu bashkarisht i kanë mësuar fëmijët në mektebin e xhamisë.

Mektebi i xhamisë ndodhet në shtresën e poshtme të xhamisë dhe është i paisur me kushte të nevojshme që mësimi të zhvillohet në mënyrë të rregullt.

Rroga e hoxhallarëve sigurohet nga tubimi i të hollave nga antarët e xhamisë, që çdo shtëpi e ka për detyrë të paguajë nga 1000 denarë në vit. Kjo xhami me rastin e hapjes së saj, ka numëruar 175 shtëpi të cilët janë antarësuar në të.

Me përmbylljen e vitit 2009, arkatari i xhamisë ka dhënë raport se për vitin 2009 janë tubuar 109.540 denarë, 1260 euro dhe 200 franga zvicerane. Ndërsa janë harxhuar 108.806 denarë dhe 260 euro.

2010

Gjatë fillimit të vitit 2010, është vazhduar në mënyrë të rregullt aktiviteti dhe puna në xhaminë e re. Hoxhallarët kanë kryer detyrat me rregull dhe pa pengesa. Gjatë muajit janar janë organizuar në kuadër të xhamisë dhe dy hoxhallarët e xhamisë aktivitete me rininë e vendit, për këshilla fetare dhe njohuri mbi fenë Islame dhe degët e saja. Aktivitetet janë realizuar nëpër shtëpi private, ndërsa tubimi i parë ka qenë në shtëpinë e hoxhës Shaban më 9.01.2010 e shtunë.

Me datë 25.02.2010 ditë e enjte, në xhaminë tonë, me inicim të hoxhës Shaban Tairi, organizohet një tribunë me rastin e Ditëlindjes së Muhamedit alejhi selam, ku prezent kanë qenë disa hoxhallarë, ligjëruesa ka qenë hoxha Semi Ajeti nga Shkupi, për recitim të mevludit ka qenë Mixhit Osmani nga Tetova, lexim Kurani ka performuar hoxha Nesim Bajrami nga Studeniçani dhe për performimin e ilahive ka qenë hoxha nga fsh. Shishovë, Muhamed Halili dhe Sadri Ilazi nga Kumanova.Duanë e ceremonisë e ka bërë hoxha i xhamisë "Husejn Shah" në Saraj, mulla Orhan Salihu.

Që nga hapja e xhamisë, vazhdimisht është punuar për t`i mundësuar popullatës kryerjen e riteve fetare, që të kompletohet xhamia me kushtet bazë dhe me përmbushjen e nevojave kryesore, ku më pas, paraqitet kërkesa në institucionet përkatëse, që xhamia jonë të hapet zyrtarisht.

Gjatë muajit mars të këtij viti, është bërë përgatitja e mektebit të xhamisë dhe paisja e saj me nevojat elementare dhe është bërë blerja edhe e disa rafteve dhe librave, për të formuar librarinë e xhamisë.

Me datë 26.05.2010 ditë e mërkurë, bëhet edhe hapja zyrtare e xhamisë së Tretë në Saraj, ku prezent në këtë manifestim, ishin kryetari i BFI-së Sulejman Rexhepi, ish-myftiu i Shkupit Ibrahim Shabani, myftiu i Gostivarit Shaqir Fetahu, myftiu i Kumanovës dhe Kërçovës, imamët e rrethit dhe shumë xhematë të cilët prezantuan në këtë rast solemn për këtë lagje të Sarajit. Me rastin e mbajtjes së fjalimit të krytarit, dekreti për imam i dorëzohet hoxhës Shaban Tairi dhe çelësat e xhamisë i jepen kryetarit të xhamisë, Amet Asani.

Me përfundimin e ceremonisë, menjëherë pas asaj dite, tubohen këshilli i xhamisë në mbledhje, për të diskutuar marrëveshjen e re me imamin, pasi prej momentit të lëshimit zyrtarë të xhamisë, është bërë kontrata që të vazhdohet vetëm me një hoxhë, pasi për xhaminë në atë periudhë, ishte e vështirë të mbulojë harxhimet për dy hoxhallarë.

Me hoxhën Shaban Tairi është bërë marrëveshje që të kryejë të gjitha shërbimet e xhamisë, si faljen e pesë kohëve të namazit, xhumatë, mësimin e fëmijëve dhe shërbimet fetare jashta xhamisë, ndërsa nga xhamia është dashur të sigurohen nga 12.000 denarë si rrogë mujore.

Me fillimin e muajit të Ramazanit, me datë 11.08.2010 e mërkurë, në këtë xhami hoxha Shaban Tairi i ka falur teravitë dhe ka mbajtur ligjerata para çdo namazi të teravisë. Përgjatë muajit të Ramazanit, hoxha ka bërë ndërrime me hoxhallarët e xhamive tjera të rajonit, ku hoxha ynë ka ligjëruar nëpër xhamitë tjera, ndërsa në xhaminë tonë kanë ardhur mysafirë të cilët kanë mbajtur ligjerata, për të ndryshuar sadopak atmosferën e muajit të bekuar të Ramazanit.

Pas përfundimit të Ramazanit, fillohet me mësimin e Kuranit për gjeneratën e më të riturve, ku ka pasur një interesim të veçantë dhe ata që kanë ndjekur mësimet te hoxha Shaban Tairi ka qenë i konsiderueshëm. Për zhvillimin e mësimit të texhvidit të Kuranit, hoxha u ka përgatitur edhe një material mësimorë i cili u është shpërndarë të githëve nga një kopje.

Në xhaminë tonë, përpos ligjëratave të rregullta, nga hoxha Shaban Tairi janë zhvilluar edhe ligjërata shtesë mbi rregullat e abdesit dhe namazit, të cilat janë mbajtur pas jacisë ditëve të enjte, kurse me këtë cikël ligjëratash është filluar prej më 8.10.2009 deri më 8.08.2010.

Me afrimin e fundit të vitit, konkretisht më 10.12.2010, hoxha Shaban Tairi ka ndërprerë marrëdhënien e punës me xhaminë e Tretë të Sarajit dhe ka shkuar në Gjermani, me çka edhe pushon marrëveshja e punës.

Në xhami, punën e ligjëruesit për ditëve të xhuma e merr hoxha nga Saraj Fadil Ramadani, kurse për faljen e pesë kohëve të namazit dhe obligimet tjera, angazhohet hoxha nga Lubini, Shefko Zeqoviq.

Me përfundimin e vitit, arkatari i xhamisë Amet Tairi jep raportin e rregullt vjetorë për aktivitetin financiar të xhamisë, ku deklarohet se gjatë vitit 2010, në arkën e xhamisë janë tubuar 61.440 denarë, 895 euro, 200 kruna norvegjeze dhe 100 franga zvicerane.

Ndërsa për nevojat e xhamisë, nga janari deri në këtë periudhë, janë harxhuar 83.714 denarë dhe 1470 euro.

2011

Përgjatë vitit 2011, aktivitetet janë zhvilluar në mënyrë të ngadalësuar por të rregullt, hoxhallarët e kanë kryer detyrën me përpikmëri kurse këshilli ka vazhduar punën. Në periudhën e parë të vitit 2011, pasi këshilli i xhamisë dha dorëheqje nga pozita e udhëheqësisë së xhamisë, u vendos që të zgjidhet këshilli i ri që do të udhëheq me proceset e xhamisë, ku u vendos të formohet këshilli i tretë me rradhë i kësaj xhamie në përbërje të këtillë:

Feim Ilazi si muteveli i xhamisë, Qani Haxhiu si arkëtarë i xhamisë, ndërsa anëtarë tjerë u zgjodhën Feim Tairi, Sali Aliu, Abedin Aliu, Zekeria Kadriu, Bekim Qaili dhe Kadrush Shabani.

Më pas është marrë iniciativa për të ndërtuar një murrë përreth xhamisë, iniciativë të cilës i ka paraprirë antari i këshillit të xhamisë Abedin Aliu, i cili ka paguar diku në mes 4000-5000 euro për ndërtimin e këtij murri.

Me datë 29.09.2011 në oborrin e xhamisë, ndërtohet edhe një shatërvan nga një xhematë i cili gjendet me vendbanim në afërsi të xhamisë, por me punë në diasporë.

Gjatë muajit të Ramazanit, i cili filloi më 1.08.2011, si ligjërues në xhami është angazhuar mulla Remzi Osmani nga fsh. Sullare e poshtme.

Pas muajit të Ramazanit, si imam dhe ligjërues në xhami punësohet hoxha nga Saraj, Besir Duraku, i cili shërben deri në fund të vitit.

2012

Në fillim të vitit 2012, konkretisht më 14.02.2012 e martë, me muteveliun e xhamisë Feim Ilazi, Esat Lokun dhe myftininë e Shkupit, është arritur marrëveshje që të pranohet përsëri në punë hoxha Shaban Tairi për të kryer shërbimet fetare në këtë xhami. Është arritur marrëveshje që hoxhës t`i sigurohet pagesë mujore prej 15.000 denarësh, kurse hoxha t`i realizojë detyrat fetare si falja e pesë kohëve të namazit, xhumave, mësimin e fëmijëve dhe shërbimet tjera.

Me angazhimin e sërishëm të hoxhës në vendin e punës, është vazhduar me aktivitetet fetare nëpër dhoma, ku janë thirrur hoxhallarë të ndryshëm për të ofruar këshilla për rininë e Sarajit dhe rrethinës. Por kësaj rradhe, ligjëratat dhe tubimet nuk janë mbajtur vetëm në Saraj, por edhe nëpër fshatra tjera, si Bukoviq, Kondovë, etj.

Me datë 4.05.2012 e premte, për ligjëratën e ditës së xhuma, në xhaminë tonë, ka qenë mysafir Fevzi Musliu, në atë kohë kryetarë i Forumit Rinor Islam, me të cilin pasi kemi përfunduar me faljen e xhumasë, kemi qenë në piknik me rininë e Sarajit në fshatin Raoviq, ku atje është mbajtur një ligjeratë enkas për të rinjtë, ndërsa prezent kanë qenë edhe disa hoxhallarë të rrethit.

Me datë 13.07.2012 e premte, për ligjëratën e ditës së xhuma, në xhaminë tonë, ka qenë mysafir Prof.Dr. Bejadin Ameti nga Kumanova, me të cilin pasi kemi përfunduar faljen e xhumasë, kemi qenë në piknik me rininë e Sarajit në Matkë, ku atje po ashtu ka dhënë edhe këshilla tjera për rininë dhe aktivitetet Islame.

Me ardhjen e muajit të Ramazanit (20.07.2012), hoxha Shaban Tairi ka mbajtur ligjerata para çdo teravije, ndërsa për faljen e namazeve të teravisë e ka angazhuar hoxhën Besir Duraku nga Lubini. Podrumi i xhamisë ka qenë në disponim për faljen e teravisë nga gjinia femërore, të cilët përmes mikrofonit kanë pasur mundësinë të dëgjojnë ligjëratën dhe faljen e teravisë. Edhe në këtë muaj të Ramazanit është vazhduar me aktivitete të ndryshme ku hoxhallarë të ndryshëm kanë ardhur për të ligjëruar në xhaminë tonë, kurse imami jonë ka shkuar nëpër xhami tjera, si aktivitet i përbashkët i hoxhallarëve të Dervenit.

Për netët e teravisë, xhemati paguan rregullisht nga 300 denarë për antarë të shtëpisë që marrin pjesë në falje të teravive, e cila paguhet në mënyrë vullnetare, ndërsa tubohet nga këshilli i xhamisë në lokalet e xhamisë. Kjo tarifë është e njëjtë që nga hapja e xhamisë dhe vazhdon në këtë mënyrë. Për hoxhallarët janë tubuar afro 1000 euro, të cilat i kanë ndarë në mes tyre hoxha Shaban dhe Besir.

Me datë 10.12.2012 e hënë, në lokalet e Xhamisë së Re në Saraj, u mbajt mbledhje në të cilën morën pjesë mutevelitë dhe hoxhallarët e të tre xhamive të Sarajit dhe është diskutuar që të punësohet një punëtorë tek varrezat dhe të organizohet në mënyrë të përbashkët ceremonia e varrimit. Punëtori i varrezave paguhet nga 250 euro, të cilat sigurohen nga fondi i xhamive.Po ashtu paguhet nga 2000 denarë për gërmimin e varrit. Punëtori po ashtu, ka për detyrë që të pastrojë dhe mirëmbajë varrezat dhe të kujdeset për vendin dhe rregullin. Gjithashtu, është sjellur vendim që xhemati me rastin e vdekjes të paguajë 200 euro, ndërsa nga xhamia përkatëse t`i sigurohen të gjitha nevojat për realizimin e ceremonisë së varrimit, si qefini, dërrasat e varrit, larja e xhenazes, falja e namazit të xhenazes, tespihët dhe të gjitha gjërat tjera të nevojshme. Ky vendim i të tre xhamive, është miratuar edhe nga myftinia e Shkupit.

Kurse në përfundim të vitit, me datë 28.12.2012 e premte, para namazit të xhumasë, është mbajtur programi i hatmes nga talebet e xhamisë tonë, të cilët kanë mësuar nga hoxha Shaban Tairi dhe kjo njëherësh është

gjenerata e parë e talebeve të cilët kanë kryer mësim-besimin në mektebin tonë. Gjithësej kanë përfunduar 9 talebe të cilët janë: Selma Merseli, Alije Aliu, Merita Loki, Ermira Aliu, Sevnure Aliu, Zelie Veseli, Hatixhe Ilazi, Alma Salihu dhe Ali Aliu.

2013

Përgjatë fillimit të vitit 2013, veprimtaria në xhami është zhvilluar në mënyrë të rregullt, kurse më 26.05.2013 e diel, hoxha Shaban me të rinjtë e muhallës kanë dalur në piknik në parkun e Sarajit, ku është përgatitur ushqim, janë zhvilluar biseda të ndryshme, këshilla fetare, lojëra sportive dhe aktivitete të ndryshme, që të rinjtë të jenë sa më pranë aktiviteteve fetare dhe ndihmës së xhamisë.

Më 25.05.2013, rinia e xhamisë tonë diskutojnë për formimin e një faqe të rrjetet sociale, e cila do të jetë në shërbim të popullit për t`i informuar të tjerët për aktivitetet e xhamisë tonë, kështu që u krijua një faqe në facebook e cila ende sot e kësaj dite funksionon në mënyrë të rregullt dhe shërben për të informuar masën për aktivitetet dhe zhvillimet e xhamisë, ndërsa menaxhohen nga antarë të xhamisë dhe hoxha i xhamisë.

Aktivitetet e rinisë në bashkëpunim me hoxhën nuk kishin të ndalur, kështu që pas disa bisedimeve, u vendos që të mbahet një tribunë fetare në të cilën do të trajtohen tema me dobi dhe interes të udhëzimit të rinisë. Me datë 5.06.2013, e mërkurë, pas namazit të akshamit, është mbajtur tribunë fetare me rastin e natës së Israsë dhe Miraxhit, ndërsa mysafir për të ligjëruar, ishte hoxha Qenan Ismaili, për lexim të Kuranit ishte prezent hoxha Suat Idrizi, ndërsa për lexim të ilahive ishte hoxha Besim Memedi dhe Muhamed Halili.

Interesimi për prezencë në këtë tribunë ishte i madh dhe efekti i pritur. Më pas, rinia së bashku me hoxhallarët kanë dalur në një kafiteri lokale dhe kanë vazhduar bashkëbisedimin me hoxhallarët për të përfituar nga këshillat e tyre.

Me datë 16.06.2013 e diel, mektebi i xhamisë tonë ka marrë pjesë në garat kuranore të organizuara nga myftinia e Shkupit, ku mektebi i jonë ka marrë pjesë me dy talebe të cilët kanë mësuar te mualimi i xhamisë, Shaban Tairi.

Me datë 21.06.2013, e premte, me ftesë të hoxhës së xhamisë tonë, si ligjërues në xhaminë tonë për ditën e xhuma, ka qenë hoxha i mirënjohur Omer Musa, i cili punon në Sh.B.A. si hoxhë. Pas xhumasë, me

rininë e xhamisë, kemi shkuar në piknik në fshatin Raoviq, ku me këshilla dhe nasihat, ka qenë i angazhuar hoxha Shaban Tairi, Zeqirja Tairi dhe hoxha Suat Idrizi nga Bukoviqi.

Me fillimin e muajit të Ramazanit më 9.07.2013, ligjërues për teravi ishte si zakonisht hoxha i xhamisë Shaban Tairi, kurse për faljen e namazeve të teravisë është angazhuar Besir Duraku. Podrumi ka qenë i hapur në teravi për gratë të cilëve u është dhënë mundësia të prezantojnë përgjatë teravive, pasi podrumi posedon autoparlantë të cilët e përcjellin poshtë ligjëratën dhe faljen e namazit. Po ashtu, për gratë ka pasur edhe ligjerata përgjatë ditëve të javës nga teologe Rejhane Ajdari.

Me datë 1.08.2013 e enjte, në xhaminë tonë, hoxha Shaban në bashkëpunim me rininë e muhallës, organizoi edhe një iftar të përbashkët për rininë dhe mysafir të ndryshëm në oborrin e xhamisë tonë.

Në ditën e Fitër Bajramit, me datë 8.08.2013, e enjte, para faljes së namazit të Bajramit, është zhvilluar programi i hatmes të talebeve që kanë mësuar në mektebin e xhamisë tonë te mualimi Shaban Tairi, që njëherësh është edhe gjenerata e dytë e cila përfundon mësim-besimin Islam në mektebin e xhamisë tonë. Dilpomuan gjithësej 13 talebe, të cilët ishin: Isra Ademi, Merije Ismaili, Sami Zekiri, Sami Salihu, Nermine Aliu, Egzon Ismaili, Elma Isaku, Ibrahim Merseli, Zehra Aliu, Selman Ismaili, SemihZekiri, Fatih Ajdini dhe Rami Aliu.

Me datë 26.08.2013 e hënë, pas ikindie, me rininë e muhallës kemi qenë në piknik të organizuar nga hoxha Shaban bashkë me të rinjtë, kurse mysafir ishte edhe hoxha i mirënjohur i trojeve tona, Dr. Zekerija Bajrami, i cili mbajti këshilla dhe mësime për të rinjtë tanë.

Me fillimin e vitit 2013, në koordinim me xhamitë tjera të Sarajit, kemi ardhur në përfundim që t`a ngritim çmimin e antarësisë, ku prej fillimit të këtij viti, antarët është dashur të paguajnë nga 1200 denarë (20 euro) në vit për antarësi.

2014

Me fillimin e vitit të ri, xhamia e jonë vazhdon me aktivitete të rregullta dhe aktivitete të ndryshme në bazë të paraqitjes së nevojës.

Më 25.01.2014, e shtunë, hoxha jonë në bashkëpunim me shoqatën "Fëmijët e paqes" në Saraj, fillojnë një iniciativë fisnike për të tubuar tesha për veshëmbathje, të cilat do të dërgohen në kampin e refugjatëve sirianë në Turqi. Aksioni ka përfunduar më 26.02.2014.

Rinia e jonë në bashkëpunim me hoxhën Shaban Tairi, morrën iniciativë për pastrimin e të gjithë rrethit të xhamisë dhe muhallës nga mbeturinat dhe deponinë e egër të formuar përreth autostradës që gjendet në afërsi të xhamisë, kështu që me datë 6.02.2014, është punuar intenzivisht përgjatë tërë ditës nga një grup i të rinjëve derisa tërësisht është pastruar rrethi nga mbeturinat.

Edhe në këtë vit, hoxha jonë në bashkëpunim me hoxhallarët e rajonit dhe rininë e Sarajit, kanë organizuar mexhlise nëpër shtëpi, disa në Saraj, në Nova Sellë të Tetovës e vende tjera, kurse më 11.02.2014, e martë, pas jacije, kemi qenë në mexhlis në Lubin, ndërsa mysafir të ftuar e kemi pasur hoxhën të mirënjohur nga Gostivari, Mr. Amet Memeti.

Me datë 28.06.2014 ka filluar muaji i bekuar i Ramazanit, gjatë të cilit janë zhvilluar aktivitete të rregullta dhe të dobishme. Ligjërues para namazeve të teravisë ka qenë si zakonisht hoxha i xhamisë Shaban Tairi, kurse për faljen e namazeve të teravisë është angazhuar hoxha Besir Duraku nga Lubini. Para namazit të drekës dhe të ikindisë është filluar edhe me leximin e mukabeleve para xhematit, kurse lexues kanë qenë po këta hoxhallarë të lartëpërmendur. Gjithashtu hoxha i jonë është ndërruar me hoxhallarë të rajonit, kështu që xhemati vazhdimisht është freskuar gjatë teravive me hoxhallarë të ndryshëm. Për gratë, ka ligjeruar teologe Rejhane Ajdari në ditën e shtunë dhe të mërkurë pas namazit të drekës.

Këtë vit, në hyrje të xhamisë, është vënduar edhe një tabelë në të cilën janë shënuar disa të dhëna kryesore mbi xhaminë tonë, kurse pagesën e saj, e bëri Sefedin Isha nga Gostivari.

Gjatë këtij viti, shkaku i shtimit drastik të numrit të xhematit që vizitojnë xhaminë tonë, është hapur edhe podrumi i xhamisë për burrat, që të mund

të falin namazin e xhumasë dhe të përcjellin ligjeratat e hoxhës Shaban Tairi.

Vlen të përmendet se ngrohja e xhamisë bëhet me nxehje qëndrore, kurse gjatë verës, me klimatizerë dhe ventilatorë, të cilat janë në numër të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e xhamisë. Për pastërtinë e xhamisë kujdesen besimtarë vullnetarë, që për çdo të enjte e pastrojnë xhaminë.

Edhe këtë vit, nga mualimi i xhamisë tonë, Shaban Tairi është përgatitur një grup i talebeve për të përfunduar kursin e mësim-besimit fetar, kurse këtë vit, numërohet gjenerata e tretë e mektebit të xhamisë tonë. Në këtë grup kanë kryer mësimin 16 talebe, të cilët janë: Mervan Ismani, Miraxh Ismani, Hadis Shabani, Subijat Skenderi, Jasmina Skenderi, Qefsere Skenderi, Zirka Nuhiu, Eljesa Azizi, Xheneta Memeti, Merlinda Aliu, Amra Mazllami, Maida Sheipi, Naile Mazllami, Besim Aliu, Isra Sinani dhe Ali Ismani.

Me datë 3.05.2014, dy nxënëse të mektebit tonë, kanë marrë pjesë në garat e dyta kuranore të organizuara nga myftinia e Shkupit në nivel qyteti.

2015

Me fillimin e vitit të ri, vazhdojnë edhe aktivitetet e ndryshme në xhaminë tonë, për të zhvilluar jetën fetare dhe për të stimuluar të rinjtë në vepra të mira. Përpos aktiviteteve të zakonshme, janë zhvilluar edhe disa aktivitete të ndryshme, të cilat do t`i përmendim përmbledhtas në vijim.

Me datë 24.01.2015 e shtunë, pas namazit të drekës, xhamia jonë në bashkëpunim me Forumin Rinor Islam zhvilloi në xhaminë tonë një tribunë për gjininë femërore, ndërsa ligjëruese ishte Esma Sherifi Kurti, që trajtoi një temë me titull: "Muhamedi a.s. shembëlltyrë në çdo kohë".

Më 2.02.2015, me iniciativë të Esad Lokut, montohen parmak në kuben e xhamisë, për të lehtësuar ngjitjen dhe pastrimin e kubes.

Me datë 27.04.2015, tre talebe të mektebit tonë, Sara Kadriu, Medina Bajrami dhe Isa Dasic, kanë marrë pjesë në garat kuranore në nivel të qytetit, të organizuara nga myftinia e Shkupit, ndërsa janë mbajtur në xhaminë Mustaf Pasha në Shkup.

Më 11.05.2015, me iniciativë të rinisë së xhamisë dhe të muhallës tonë, u ndërmor një akcion për riparimin e rrugës kryesore (rruga 6), shkaku i prishjes së tepërt të saj dhe dëmtimit të veturave, u bisedua që të tubohen disa mjete të cilat do të jenë të nevojshme për të riparuar rrugën me beton. Është biseduar edhe me prodhuesin e betonit në Saraj dhe është filluar realizimi i projektit.

Për realizimin e këtij projekti janë nevojitur 1000 euro, të cilat janë siguruar shpejt. 550 euro janë tubuar ditën e xhuma në xhami pas faljes së xhumasë, 220 euro janë tubuar nga rinia nëpër donatorë të ndryshëm dhe vullnetarë, kurse pjesën tjetër e ka mbuluar betonjerka "Getoar" në Saraj.

Me datë 26.05.2015, hoxha jonë Shaban Tairi në bashkëpunim me hoxhallarët Zekerija Tairi dhe Suat Idrizi, bashkë me të rinjtë e muhallës, kanë dalur në piknik në fshatin Raoviq, ku është shfrytëzuar rasti për bashkëbisedime dhe konsultime fetare.

Me ardhjen e muajit të Ramazanit më 17.06.2015, në xhaminë tonë fillon organizimi i realizimit të këtij muaji në mënyrë sa më të sukseshme. Për ligjerata para teravije është angazhuar si zakonisht hoxha Shaban Tairi, ndërsa për faljen e namazeve të teravisë, këtë vit e kanë angazhuar hoxhën nga Bukoviqi, Suat Idrizi. Edhe këtë vit podrumi i xhamisë ka qenë në disponim për gjininë femërore, për t`i falur teravitë dhe për të dëgjuar ligjëratën. Ndërsa dy herë brenda javës, të mërkurën dhe të shtunën pas dreke, ka pasur ligjëratë enkas për gjininë femërore, ku për këtë qëllim, xhamia ka angazhuar teologen Rejhane Ajdari.

Pas përfundimit të Ramazanit, me rininë e xhamisë, përsëri është organizuar dalje në natyrë (piknik) në të cilin janë zhvilluar aktivitete sportive, ushqim, biseda fetare dhe këshilla të ndryshme. Kjo është realizuar më 2.08.2015 në parkun e Sarajit.

Kah fundi i vitit, si zakonisht për netët e dalluara fetare, kemi përgatitur ndonjë tribunë apo ligjëratë për xhematin, që të info-rmohen rreth historikut dhe vlerës së asaj nate.

edhe me rastin e vitit të ri Hixhri 1437, në xhaminë tonë u organizua një tribunë madhështore, ku pati shumë mysafir dhe të interesuar.

Me datë 14.10.2015 e mërkurë, pas namazit të jacisë, në xhaminë tonë nga ana e hoxhës Shaban Tairi, u organizua një tribunë fetare, ku për ligjërues ishte i ftuar hoxha i nderuar Dr. Zekerija Bajrami, ndërsa për performimin e leximit të Kuranit dhe ilahive, ishin vëllezërit Nuhiu, Xhemaili dhe Sabaatini.

2016

Me fillimin e vitit të ri, kanë filluar edhe aktivitetet e ndryshme në xhaminë tonë. Ky vit dallohet me shumë aktivitete në sfera të ndryshme.

Xhamia jonë përgjatë këtij viti, ka pasur bashkëpunim me një gamë më të gjërë të rrethit, pra, me të rinjtë nga i gjithë Derveni.Hoxha Shaban Tairi bashkë me disa të rinjëve të cilët kanë funksionuar nën emrin "Rinia e Dervenit", kanë realizuar disa aktivitete në xhaminë tonë.

Aktiviteti i parë ka qenë tribunat e organizuara në xhaminë tonë, të cilat është planifikuar të mbahen në mënyrë të rregullt, që për çdo muaj të mbahet nga një tribunë me hoxhallarë të ndryshëm.

Tribuna e parë është organizuar më datë 31.01.2016 e diel, kurse për ligjërues është caktuar të jetë myftiu i atëhershëm i Shkupit, prof. Rexhep Jusufi nga Kondova.

Në këtë eveniment ka pasur prezent shumë mysafir, hoxhallarë nga rajoni dhe më gjërë. Ligjërata ka qenë e paraparë më shumë për orientimin e rinisë kah rruga e vërtetë dhe udhëzimi.

Ashtu siç ishte paraparë që më herët, që në çdo fund të muajt të mbahet nga një tribunë, me afrimin e fundit të muajit të dytë, është paraparë që të ftohet si ligjërues në tribunën e dytë fetare të organizuar në xhaminë tonë, hoxhë Sadush Tahiri nga Shkupi. Kjo tribunë është realizuar më 26.02.2016 e diel, ndërsa interesimi për prezentim në këtë ligjëratë, ka qenë shumë i lartë.

Në këtë ligjëratë kanë prezantuar shumë mysafir të ndryshëm si dhe përfaqësues të myftinisë së Shkupit. Ligjërata kishte për fokus rininë dhe edukimin e tyre.

Pas përfundimit të ligjëratës, organizatorët bashkë me një numër të mysafirëve kanë dalur në kafiteri lokale për t`i gostitur mysafirët.

Gjatë këtij muaji, është organizuar edhe ceremonia e hatmes së talebeve që kanë mësuar në mektebin e xhamisë tonë. Kjo gjeneratë është gjenerata e katërt e talebeve që kanë përfunduar leximin te mualimi i xhamisë, Shaban Tairi. Në këtë gjeneratë, hatmen dhe përfundimin e mësim-besimit e kanë kryer 11 talebe. Ceremonia është mbajtur me datë 20.03.2016 e diel, kurse prezent kanë qenë edhe shumë hoxhallarë dhe përfaqësues të myftinisë së Shkupit. Për mysafirët është përgatitur në oborrin e xhamisë gosti dhe ushqim.

Talebet që kanë kryer hatme janë: Almir Mazllami, Sait Mazllami, Bujamin Kadriu, Isa Dasiç, Ardian Kadriu, Hamza Sadiku, Aishe Loki, Sara Kadriu, Medina Bajrami, Hansa Ramizi dhe Ferizate Bajrami.

Më pas është vazhduar me tribunat e rregullta dhe është organizuar tribuna e tretë me rradhë.

Në këtë tribunë, është ftuar profesori i hadithit në Fakultetin e Shkencave Islame, Doc. Bejadin Ameti nga Kumanova. Kjo tribunë është oranizuar më datë 27.03.2016 e diel, ndërsa për fokus ligjerata ka pasur pastrimin e fjalorit dhe gjuhës.

Është një fakt për tu përmendur që, të gjitha ligjëratat të cilat janë mbajtur në xhami, janë inçizuar dhe më pas janë publikuar në rrjetet sociale dhe në kanalin tonë në youtube.

Pas përfundimit të ligjëratës, me hoxhallarët dhe mysafirët, është vazhduar kuvendimi në një restorant lokal, ku të pranishmit, kanë parashtruar pyetje dhe kanë hapur tema fetare, për të përfituar prej profesorit sa më shumë.

Në muajin prill, është vazhduar me këtë aktivitet të dobishëm, ku për ligjëratën e katërt me rradhë, është ftuar hoxha i njohur në rrethin e Shkupit, Abdusamet Zeqiri. Me datë 24.04.2016 e diel, është mbajtur tribuna në xhaminë tonë. Edhe ai me ligjëratën e tij, pati ndikim dhe efekt pozitiv tek xhemati dhe u mirëprit ligjërata nga të rinjtë. Pas përfundimit të ligjëratës, mysafirët janë gostitur në ëmbëltoren lokale në Saraj dhe janë nderuar për vizitën që na kanë bërë.

Më 15.05.2016, është filluar të ndahet një pjesë e lokaleve të podrumit për të ndërtuar një zyre të madhe, e cila do të shërbejë për mirëpritjen e mysafirëve, mbajtjen e mbledhjeve të këshillit të xhamisë, mbajtjen e dokumenteve dhe arhivës së xhamisë dhe shfrytëzimi i saj për aktivitete të ndryshme me karakter fetar dhe shoqërorë.

Më 24.05.2016, nga komuna e Sarajit, për xhaminë tonë kanë dhuruar disa paisje të hekurit për lidhjen e biçikletave. Po ashtu janë sjellur edhe karrige të metalit për t`u ulur njerëzit të pushojnë pranë xhamisë.

Po ashtu, gjatë çdo tri mujori, mualimi me talebet e mektebit tonë, kanë marrë iniciativë për pastrimin e rrethit të xhamisë dhe largimin e mbeturinave nga ambienti i xhamisë.

Me datë 29.05.2016, e diel, në xhaminë tonë, është oranizuar tribunae pestë me rradhë në bashkëpunim të hoxhës Shaban Tairi me "Rininë e Dervenit". Këtë rradhë, mysafir për të ligjëruar, është ftuar hoxha i mirënjohur në Shkup dhe më gjërë, mulla Llokman Kamberi, ligjërues në xhaminë e "Allaxhës" në Shkup, i cili në këtë tribunë, ka folur mbi tolerancën.

Edhe gjatë kësaj tribune, ka pasur prezent shumë mysafir dhe hoxhallarë të ndryshëm.

Me hyrjen e muajit të Ramazanit (5.06.2017) në xhaminë tonë janë mbajtur aktivitete të rregullta të Ramazanit. Ligjërues para namazeve të teravisë ka qenë hoxha i xhamisë Shaban Tairi, kurse për faljen e teravive, është inkuadruar hoxha nga Lubini, mulla Iljas Veseli. Podrumi ka qenë i hapur edhe për gratë që të mund të dëgjojnë ligjëratën e teravisë dhe të falin namazin e teravisë. Para namazit të drekës dhe ikindisë, hoxhallarët kanë kënduar edhe mukabele. Edhe këtë Ramazan ka pasur mysafir të ndryshëm të cilët kanë ardhur për të falur teravitë apo për të ligjëruar para xhematit.Po ashtu gjatë ditëve të Ramazanit, xhamia jonë për gjininë femërore, ka angazhuar edhe teologen Hafsa Rexhepi, e diplomuar në Fakultetin e Shkencave Islame. Ajo ka ligjëruar enkas për gjininë femërore çdo të martë dhe të shtunë.

Gjatë muajit të Ramazanit, xhamia e jonë në krye me hoxhën Shaban Tairi në bashkëpunim me "Rininë e Dervenit", kanë organizuar edhe një kuiz fetar për mektebet e xhamive të Dervenit. Në këtë kuiz kanë marrë pjesë nga çdo mekteb i xhamive të Dervenit nga një talebe. Çdo kandidati i është ofruar edhe një pyetësor i botuar enkas për ta, ndërsa kuizi është mbajtur me datë 22.06.2016, pas namazit të drekës, me rastin e ditës së luftës së Bedrit. Prezent kanë qenë 18 kandidatë, kurse vendin e parë e ka fituar Suela Memeti nga mektebi i xhamisë së Llaskarcës.

Pas përfundimit të muajit Ramazan, në xhaminë tonë kemi angazhuar edhe një teologe për të mësuar gratë në leximin e Kuranit dhe mësim-besimin Islam. Vlen të potencohet se në xhaminë tonë për disa vite me rradhë, Hava Shabani, i ka mësuar gratë mbi leximin e Kuranit, kurse këtë vit xhamia e ka inkuadruar edhe teologen Xheuhere Rahmani nga Saraji.

Kah fundi i vitit, konkretisht më 1.10.2016 e shtunë, xhamia jonë në krye me hoxhën Shaban Tairi, ka organizuar një tribunë Islame me rastin e Hixhretit dhe vitit të ri hixhri 1438. Këtë rradhë ligjërues ka qenë profesori universitar nga Gostivari prof. Dr. Musa Musai, i cili është ligjërues në Universitetin e Tetovës dhe ligjërues në xhaminë e Sahatit në Gostivar.

Edhe në këtë tribunë interesimi i mysafirëve ka qenë në nivel të lartë, tema ka qenë shumë e qëlluar ndërsa oratoria e profesorit i ka mahnitur të pranishmit. Në ligjëratë kanë qenë të ftuar edhe përfaqësues nga myftinia e Shkupit, kurse për leximin e Kuranit dhe ilahive, kanë qenë prezent hoxhallarët Besim Memeti dhe Burhan Rahmani.

Me këtë rast solemn, për mysafirët në oborrin e xhamisë është përgatitur një gosti, kurse për hoxhallarët dhe mysafirët e largët, është përgatitur gosti në restorantin e afërt, "Fontana".

Me angazhimin e teologes Xheuhere Ramani në xhaminë tonë, është filluar me ligjërata të rregullta edhe për gjininë femërore. Ligjëratat kanë filluar të mbahen që nga 12.11.2016 e diel pas namazit të drekës dhe brenda vitit ka mbajtur mbi 18 ligjerata.

Më 14.11.2016 për mektebin e xhamisë, është blerë një tablo e re, shkaku se tabloja e mëparshme ka qenë e vjetër dhe e papërdorshme.

Më 22.11.2016, në xhaminë tonë, hoxha Shaban Tairi ka përgatitur për ceremoninë e hatmes dy talebe, të cilët kanë mësuar me orarë privat tek hoxha, kurse në këtë ditë, ata kanë mbajtur në xhami ceremoninë e hatmes. Dy talebet nga Saraj, Hamza dhe Muhamed Smajli, në prezencë të përfaqësuesve të myftinisë dhe mysafirëve në xhami, kanë prezantuar njohuritë e tyre elementare mbi fenë Islame. Pas përfundimit të programit, dy talebeve u është shpërndarë edhe diploma.

Me afrimin e Ditëlindjes së Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe ditës së Mevludit, në xhaminë tonë është organizuar tribunë fetare me datë 12.12.2016, ditë e hënë, kurse mysafir i ftuar për të mbajtur ligjëratë, ka qenë profesori i hadithit në Fakultetin e Shkencave Islame, Prof. Dr. Faredin Ebibi nga Kumanova.

Pas përfundimit të tribunës, në zyren e xhamisë është mbajtur aktivitet fetar me hoxhallarë dhe të rinjtë, ku është vazhduar me këshilla dhe tema fetare.

Me datë 23.12.2016, në xhaminë tonë, ka ardhur një delegacion nga kisha e komunës së Gjorçes, në krye me priftin Ivica, të cilëve u kemi ofruar informacione mbi xhaminë tonë, mbi ritualet fetare, mbi namazin, u kemi ofruar edhe libra dhe materiale fetare në gjuhën maqedone dhe një gosti në zyren e xhamisë.

2017

Me datë 12.01.2017 me disa të rinjtë të Sarajit, kemi kuvenduar në zyren e xhamisë tonë pas namazit të sabahut dhe më pas kemi dalur në shëtitje në malin "Vodno" dhe këtë ecje e kanë shfrytëzuar edhe për aktivitet fetar, ku janë diskutuar edhe çështje të ndryshme.

Këtë aktivitet e kanë përsëritur edhe më datë 15.01.2017, ku pas faljes së namazit të sabahut, kanë qëndruar në zyrën e xhamisë e më pas kanë dalur në ecje në malin "Vodno" me disa të rinj nga Saraj.

Me datë 24.01.2017, pas namazit të jacisë, është mbajtur një me-xhlis në zyrën e xhamisë tonë me të rinjtë e lagjes dhe rrethit, kurse mysafir për të mbajtur ligjeratë dhe këshilla fetare, kanë qenë hoxha i Bukoviqit Zeqirja Tairi dhe hoxha nga Gërçeci Besim Memedi.

Edhe këtë vit është vazhduar me ligjeratat për gjininë femërore nga teologe Xheuhere Rahmani, të cilat i ka mbajtur rregullisht në xhaminë tonë pas namazit të drekës.

Më 12.02.2017 e diel, pas namazit të jacisë ka pasur mexhlis në zyrën e xhamisë me rininë e Sarajit, kurse mysafir për ligjërim, ka qenë hoxha nga Bojana, Omer Arsllani.

Me datë 23.02.2017, po ashtu zyra e xhamisë është shfrytëzuar për aktivitet me rininë, ku ligjërues ka qenë hoxha ynë, ndërsa numri i të rinjëve prezent ka qenë i konsiderueshëm.

Më 26.02.2017, ka pasur mexhlis me rininë e Sarajit, ndërsa mysafir për ligjëratë dhe këshilla, ishte hoxha i fshatit Shishovë, Muhamed Halili.

Më 12.03.2017, ka pasur mexhlis me rininë e Sarajit, ndërsa mysafir për ligjëratë dhe këshilla, ishte hoxha i fshatit Gllumovë, Nexhati Ameti.

Më 26.03.2017, ka pasur mexhlis me rininë e Sarajit, ndërsa mysafir për ligjëratë dhe këshilla, ishte hoxha i fshatit Kondovë, Ali Ziberi.

Me datë 30.03.2017, e enjte, pas namazit të drekës, në xhaminë tonë është mbajtur ceremonia e hatmes nga gjenerata e pestë e talebeve të mektebit tonë që kanë mësuar te mualimi Shaban Tairi.

Në këtë ceremoni të hatmes, kanë qenë prezent edhe përfaqësues të myftinisë së Shkupit dhe hoxhallarë nga rrethi i Dervenit, si dhe shumë mysafir. Hatme kanë bërë këtë rradhë 11 talebe: Lavdrim Memeti, Metin Haxhiu, Almir Jakupi, Arbin Mazllami, Melinda Iseni, Sadike Iseni, Sumeja Loki, Sara Merseli, Behra Veseli, Eljesa Ajdini dhe Albina Azizi.

Me fillimin e muajit të Ramazanit në qershor të këtij viti, për ligjërues para namazeve të teravisë është angazhuar hatibi i xhamisë, Shaban Tairi, ndërsa për faljen e namazeve të teravisë hoxha Iljas Veseli nga Lubini. Para çdo namazi të drekës dhe ikindisë ka pasur lexim të mukabeleve para xhematit. Edhe këtë vit podrumi i xhamisë ka qenë në disponim për gratë që të mund të përcjellin ligjëratat e teravisë dhe të falin namazet e teravisë me xhematë. Kurse çdo të hënë dhe të enjte, pas namazit të drekës ka ligjëruar enkas për gjininë femërore teologe Xheuhere Rahmani nga Lubini. Këtë vit, për së pari herë, për gjininë femërore, teologeja e angazhuar, ka organizuar mukabele për gratë, ku për çdo ditë të Ramazanit, bashkë me gratë është lexuar një sasi e faqeve të Kuranit, me qëllim që në fund të muajit të kryejnë një hatme të përbashkët.

Me datë 5.06.2017, gjatë këtij Ramazani, për gratë është organizuar në xhaminë tonë një tribunë, kurse ligjëruese ka qenë teologe Emine Bajrami nga Saraj.

Me datë 21.06.2017, në xhaminë tonë, teologeja bashkë me disa vajza të lagjes, në xhaminë tonë kanë organizuar dramë fetare me fëmijët e xhamisë, kurse kanë performuar për gjininë femërore. Kjo është hera e parë që në një xhami organizohet dramë fetare me talebe.

Me datë 24.06.2017, mualimi i xhamisë bashkë me talebet e mektebit tonë, kanë marrë iniciativë për pastrimin e lagjes nga mbeturinat dhe papastërtitë, për ditën e nesërme të Bajramit, që në këtë ditë të madhe për muslimanët, të jetë ambienti i pastër.

Në ditën e bajramit, hoxhallarëve u janë dorëzuar paratë që janë tubuar për ta, ku këtë vit për hoxhallarët janë tubuar 75.800 denarë, kurse fitra për medresenë janë tubuar 65.000 denar që janë dorëzuarnë myftini nga këshilli i xhamisë.

Me datë 4.08.2017, këshilli i xhamisë ka dhënë dorëheqje nga pozita e tyre për shkaqe private dhe shkaku se antarët e këshillit janë shumica në moshë të vjetër, kështu që kërkuan nga xhemati të mbahet një mbledhje në të cilin do të diskutohet për kandidatët e mundshëm të cilët do të vazhdojnë me udhëheqjen e këshillit të xhamisë. Gjatë tubimit në xhami, këshilli dha raport për ecurinë dhe zhvillimet në xhami. Arkatari i xhamisë Qani Haxhiu potencoi se kur e kanë marrë detyrën në maj të vitit 2011, xhamia ka pasur borxh në myftini diku 64.000 denarë, kurse në këtë moment kur mbahet mbledhja, xhamia posedon buxhet prej 40.000 denarë. Gjithashtu lajmëroi se xhamia nuk ka asnjë borxh për rrymën, ujin apo ndaj hoxhës.

Edhe këtë vit janë tubuar ndihma në xhami për disa raste urgjente, si operacione, shtëpi për jetimë, për varrezat e Sarajit e raste të ndryshme sipas nevojës. Vlen të përmendet se për çdo vit gjatë kurban Bajramit, në xhaminë tonë janë tubuar lëkurat e kurbaneve dhe janë dorëzuar në medrese. Po ashtu, nga ana e medreses, janë dhuruar mish për rastet nevojtare, ndërsa ne si xhami i kemi shpërndarë nëpër vende të duhura.

Me datë 25.08.2017, pas namazit të jacisë, është votuar në xhami për këshillin e ri të xhamisë tonë. Xhemati kanë pasur hapësirë dy javë për të vendosur për kandidatët për këshill dhe kryetar të xhamisë. Me vendim unanim, vendoset që këshilli i katërt me rradhë i xhamisë tonë të jetë me këtë përbërje: Abedin Aliu për muteveli, Qani Haxhiu si arkatarë, ndërsa antarë tjerë janë Hamit Elezi, Fikret Kadriu, Ejup Poliku dhe Fidan Aliu.

Me datë 25.08.2017, me iniciativë të Avdil Murtezanit, antarë i xhamisë tonë, është organizuar blerja e një toke pranë oborrit të xhamisë, e cila do të shërbejë si parking për mysafirët që vijnë të falen në xhami, sidomos përgjatë xhumave dhe bajrameve kur bëhet një rrëmujë me veturat. Toka është blerë për 40 euro një metër katrorë,ndërsa janë blerë 800 m^2.

Nga ana e këshillit të xhamisë vendoset që për çdo xhuma të fundit të muajit, të tubohen ndihma për xhaminë tonë, që të ketë një buxhet të mjaftueshëm dhe të zhvillohen aktivitete dhe punë në xhami. Po ashtu, këshilli i xhamisë vendos që hoxhës t`i jepet një ditë e lirë si pushim javor, i caktohet dita e mërkurë të jetë ditë e lirë si dhe që gjatë vitit të ketë 5 javë pushim.

Me fillimin e punës nga këshilli i ri i xhamisë, muteveliu vendos që të punësojë një punëtor në xhaminë tonë, që do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e xhamisë, kurse pagimin e tij do t`a bëjë muteveliu prej parave të veta. Po ashtu, për t`i shërbyer këtij interesi të xhamisë, ka blerë një fshisë elektronike që ka kushtuar 14.000 denarë dhe ia ka dhuruar xhamisë. Nga antarët tjerë të këshillit, është ndërmarë iniciativë që të punojnë në oborrin e xhamisë dhe të rregullojnë disa gjëra që kanë ngelur pa përfunduar. Gjatë kësaj periudhe, janë rregulluar shumë defekte, si mehanizmat e dritareve, dyert, dritat e minares, llambat elektrike të xhamisë, çeshmat e shatërvanit, mikrofonat e shumë gjëra tjera.

Më 30.10.2017, në zyrën e xhamisë, është filluar me organizimin e mexhliseve me mysafir të ndryshëm, të cilët do të japin këshilla dhe ligjërata në prani të rinisë së Sarajit.

Më 5.11.2017, në zyrën e xhamisë tonë, kemi pasur mysafir hoxhën e nderuar, Sabahudin Mahmuti nga fshati Arnaqi, i cili mbajti ligjëratë dhe këshilla me të rinjtë në zyren e hoxhës në xhami.

Më 12.11.2017,në zyrën e xhamisë, kemi pasur mysafir hoxhën Fidush Ibrahimi nga fshati Matkë, i cili ka këshilluar të rinjtë dhe të pranishmit me këshilla fetare.

Më 19.11.2017, në zyrën e xhamisë, kemi pasur mysafir hoxhën Emin Emini nga Kopanica dhe Fuat Shabani nga fshati Llackarcë, që të dy kanë mbajtur fjalime dhe këshilla para rinisë së Sarajit.

Më 26.11.2017, është vazhduar me mexhliset e rregullta në zyrën e xhamisë. Këtë rradhë kemi pasur mysafir hoxhën Isak Çilafi nga fshati Raçe, hoxha Hasip Saqipi nga Çejlana dhe Hasretullah Saiti nga Saraj.

Më 3.12.2017, kemi pasur mysafir hoxhën Basri Kurtishi nga Kondova, imam në Danimark, i cili ka mbajtur ligjëratë dhe këshilla në zyrën e xhamisë tonë para të rinjëve.

Më 9.12.2017 kanë pasur hatme talebet e Hava Shabanit, mualime në mektebin e xhamisë sonë, ku i mëson në leximin e Kuranit gratë në moshë dhe vajzat e ritura.

Më 10.10.2017, xhamisë tonë i janë dhuruar dy orë muri me emrin e xhamisë, dy paisje për ngrohje dhe një masë për në zyrën e xhamisë.

Më 11.12.2017 kemi pasur mysafir hoxhën Resul Jakupi nga Krushopeku, i cili po ashtu i këshilloi të rinjtë me këshilla dhe mësime Islame.

Me datë 15.12.2017, në xhaminë tonë kemi montuar ngrohje me tela, të cilat aktivizohen automatikisht para çdo namazi dhe ndalen vetë pas namazit, me çka shpenzohet harxhimi i rrymës dhe zvogëlimi i faturës së rrymës që paguan xhamia. Këto paisje janë paguar 850 euro nga buxheti i xhamisë tonë.

Më 16.12.2017 në hyrje të derës së xhamisë, është montuar një sandëk alumini për faturat dhe letrat që vijnë në llogari të xhamisë. Këtë sandëk e ka blerë muteveliu i xhamisë me paratë e tija.

Më 17.12.2017, në zyrën e xhamisë, është vazhduar me mexhliset me të rinjtë e Sarajit, kurse mysafir kësaj rradhe ishte hoxha nga Kopanica, Shehip Ismani, hoxhë në xhaminë e Radushës.

Më 24.12.2017, në zyrën e xhamisë, e kemi pasur mysafir hoxhën Zekerija Idrizi nga Shkupi, me punë dhe aktivitet në Berlin të Gjermanisë.

Më 31.12.2017, kemi pasur mysafir në zyren e xhamisë, hoxhën Sadudin Murati nga Shkupi, imam në Krushopek, i cili po ashtu me këshilla të dobishme iu drejtua rinisë së Sarajit.

Me konsultim të këshillit të ri të xhamisë, është marrë iniciativë që të regjistrohen të gjithë antarët e xhamisë tonë dhe të numërohen sa antarë ka xhamia dhe është ardhur në përfundim pas llogaritjes, se në xhaminë tonë janë 230 antarë.

2018

Me datë 18.01.2018 është mbajtur mbledhje e rregullt e këshillit të xhamisë dhe është diskutuar për disa pika të caktuara. Në këtë mbledhje arkatari i xhamisë Qani Haxhiu ka dhënë dorëheqje dhe ka dorëzuar te këshilli i xhamisë 690 euro, 100 franga dhe 3900 denarë.

Më pas si arkatarë i xhamisë, me unitet të gjithë antarëve të këshillit vendoset që të caktohet si arkatarë i ri i xhamisë Hamit Elezi. Atij i dorëzohen 1070 euro, 4500 denarë dhe 120 franga.

Më 7.01.2018 në zyren e xhamisë kemi vazhduar me mexhliset, ku këtë rradhë e kemi pasur mysafir prof. Ali Pajaziti nga Saraj, profesor në UEIL.

Më 14.01.2018 në zyren e xhamisë kemi pasur mysafir hafiz Amir Asllani nga Tetova dhe Venhar Osmani, muezin i xhamisë së Tabanës në Tetovë. Edhe këta ligjëruan para rinisë dhe u dhanë këshilla fetare.

Edhe më 21.01.2018 është mbajtur mexhlis në zyren e xhamisë, por këtë rradhë ka këshilluar hoxha i xhamisë, Shaban Tairi.

Më 28.01.2018 në zyren e xhamisë kemi pasur mysafir hoxhën Fadil Ramadani, hatib i Xhamisë së Re në Saraj.

Më 18.02.2018 në mexhlis kemi pasur mysafir hoxhën Xhelal Zeqiri nga Studeniçani.

Më 25.02.2018 në mexhlis kemi pasur mysafir hoxhën e nderuar Mr. Iljas Skenderi nga Shishova, hoxhë në Gjermani, ku interesimi i të pranishmëve ka qenë i lartë. Kjo edhe ka qenë mexhlisi i fundit për këtë sezonë të dimrit, ku janë mbajtur 16 mexhlise me mbi 20 hoxhallarë.

Më 11.03.2018 me disa të rinjë të Sarajit pas namazit të sabahut kemi bërë mexhlis në zyrën e xhamisë, kurse më pas kemi dalur në piknik dhe ecje në Matkë.

Më 30.03.2018, në namazin e jacisë, kemi pasur mysafir referentin e myftinisë për rajonin e Dervenit, Rexhep Imeri, i cili edhe ka mbajtur një fjalim para xhematit.

Më 10.04.2018, këshilli i xhamisë ka mbajtur mbledhje të rregullt, ku në këtë mbledhje arkatari i xhamisë ka dhënë raport mbi gjendjen e buxhetit të xhamisë dhe ka deklaruar se në buxhetin e xhamisë ka: 960 euro, 220 franga dhe 1.300 denarë.

Më 13.04.2018 nga këshilli i xhamisë është marrë një iniciativë për zgjerimin e një pjese të rrugës 6 në hyrje, që të prishet një murë i cili është në posedim të Ilmiut, i cili ka pranuar që t`i rindërtohet muri nga buxheti i xhamisë, me kusht që të lirojë mbi një metro të zgjerohet rruga.



Për këtë projekt janë tubuar 65.077 denarë, prej të cilave 275 euro kemi paguar betonin (ku pronari i betonjerkës "Getoar" ka mundësuar të marrim betonin me çmim më të lirë) mjeshtri është paguar 470 euro për punën e dorës, 47.800 denarë ka kushtuar materiali ndërtimorë që është marrë në firmën "Euro Aktiva". Pra, gjithësej për këtë projekt janë harxhuar 65.000 denarë.

Në muajin korrik nga këshilli i xhamisë është marrë vendim që hoxhës së xhamisë Shaban Tairi t`i rritet rroga mujore prej 15.000 denarë në 24.000 denarë.

Më 15.05.2018, me hyrjen e muajit të Ramazanit, nga hoxha i xhamisë është parashtruar lista e temave të ligjëratave që do të mbahen në xhaminë tonë. Imam për faljen e teravive është caktuar hoxha Iljas Veseli nga Lubini. Podrumi i xhamisë është hapur për prezencën e grave dhe të kenë mundësi të dëgjojnë ligjëratat për teravi dhe të falin namazet e teravisë. Për gratë, ka ligjëruar çdo të mërkure dhe të shtune teologe Rejhane Ajdari nga Saraj. Para namazit të drekës dhe ikindisë hoxha Shaban Tairi ka lexuar mukabele para xhematit.

Më 28.05.2018, për ligjëratën e teravisë, kishim mysafir myftiun e Shkupit, Dr. Qenan Ismaili, i cili e freskoi xhematin me ligjëratën e tij të dobishme.

Vlen të përmendet se gjatë këtij muaji të Ramazani, në xhaminë tonë ka pasur mysafir të ndryshëm të cilët kanë ligjëruar para xhematit.

Edhe gjatë këtij muaji xhamisë tonë i janë dhuruar disa paisje për parfumimin e xhamisë, një karrige për ligjërim në mihrabin e xhamisë dhe disa masa për mbajtjen e Kuranit dhe leximittë tij.

Më 15.06.2018 në ditën e Bajramit, hoxhallarëve u janë dorëzuar 84.000 denarë të cilat janë tubuar enkas për hoxhallarët. Ndërsa sadakatul fitra për medresenë "Isa Beu" janë tubuar 52.000 denarë, të cilat janë dorëzuar në myftininë e Shkupit.

Gjatë muajit gusht të këtij viti, hoxha jonë Shaban Tairi ka udhëtuar për në haxh si udhëheqës për haxhinjtë e Shkupit, ndërsa zëvendës gjatë ditëve që nuk do të jetë këtu, është caktuar hoxha Muaz Mamuti.

Më 25.09.2018, mektebit të xhamisë tonë, i është dhuruar një projektor i cili do të shërbejë për zhvillimin më cilësor të mësimit në mekteb. Projektori ka kushtuar 21.000 denar, ndërsa e kanë dhuruar Kenan Ademi dhe Nehati.

Gjatë muajit tetor është ndërruar mikseta e mikrofonave të xhamisë dhe dera e minares. Kurse në muajin nëntor në xhaminë tonë u montuan disa rafte për bibliotekën e xhamisë që u dhuruan nga puntoria "Beso Dizajn".

Kurse në muajin nëntor është montuar një klimë në mektebin e xhamisë, e dhuruar nga një donatorë anonim nga Amerika.

Më 20.11.2018 në xhaminë tonë, është organizuar një tribunë fetare me myftininë e Shkupit, me rastin e ditëlindjes së Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërsa ligjërues ka qenë myftiu i Shkupit, Dr. Qenan Ismaili.

Për recitimin e Kuranit dhe ilahive ka qenë prezent hafiz Xhemail Nuhiu dhe shumë mysafirë tjerë, e për ta në fund është përgatitur një koktel në podrumin e xhamisë.

Më 30.11.2018, në zyrën e xhamisë tonë, kanë filluar orët për mësimin e Kuranit për të rritur, ku janë zhvilluar mësime mbi shkencën e Texhvidit dhe drejtleximit të Kuranit, si dhe pas leximit të Kuranit, janë mbajtur sesione me këshilla fetare dhe pyetje përgjigje me të pranishmit.

Me afrimin e fundit të vitit, me konsultim të hoxhës dhe këshillit të xhamisë, është ardhur në përfundim që për hir të dhjetë vjetorit të hapjes së xhamisë, të përgatitet një kalendar me fotografinë e xhamisë tonë. Botimin e këtij kalendari për vitin 2019 e ka finansuar Naser Kadriu.

Ky kalendarë është shtypur në 50 kopje dhe është shpërndarë nëpër xhematin e kësaj xhamie.

Më 22.12.2018 talebeve të mektebit tonë, u është shpërndarë libri "Njohuri themelore të fesë Islame" që është finansim i myftinisë së Shkupit, që është shpërndarë për mektebet e Shkupit, kurse talebet obligohen të mësojnë prej këtij libri.

Po ashtu, në xhumanë e fundit të këtij viti, është lajmëruar se myftinia në gjithë territorin e Shkupit ka ngritur çmimin e antarësisë, kështu që prej fillimit të vitit 2019, antarët obligohen të paguajnë nga 1800 denarë në vit apo 30 euro.

Gjithashtu shërbimi i varrimit është ngritur në 230 euro për raste vdekje, që duhet ta paguajnë antarët nëse dëshirojnë që tërë shërbimin tua përgatit xhamia.

2019

Fillimin e vitit 2019 e karakterizoi votimi për këshille të xhamive në mbarë rajonin e Shkupit të organizuara nga myftinia e Shkupit, kështu që edhe në xhaminë tonë u votua për këshill xhamie. Këtë rradhë, nuk pati shumë ndryshime në këshill të xhamisë, përpos që dy prej antarëve të mëparshëm nuk u rivotuan, ndërsa u votua për pesë antarë të rinjë. Votimet u mbajtën më 3.02.2019, kurse antarët e këshillit të pestë me rradhë të xhamisë janë si vijojnë: Abedin Aliu për muteveli, Hamit Elezi për arkatar të xhamisë, kurse antarë të këshillit u zgjodhën: Sedat Izeti, Fikret Kadriu, Ramadan Ademi, Nafi Qaili, Nijazi Asani dhe Sali Aliu.

Më 14.03.2019 në xhaminë e Re në Saraj është mbajtur një kuiz fetar në nivel të Shkupit, ku kanë marrë pjesë mektebet nga i gjithë qyteti, ndërsa organizatorë ka qenë myftinia e Shkupit. Edhe nga xhamia e jonë ka pasur kandidate, që ka marrë pjesë në kuizin e diturisë.

Më 31.03.2019, në restorantin Fafa, është mbajtur ceremonia e hatmes nga talebet që kanë mësuar në mektebin e xhamisë tonë tek mualimja Hava Shabani, ku kanë përfunduar me leximin e Kuranit mbi 30 gra.

Me fillimin e muajit të Ramazanit më 3.05.2019, në xhaminë tonë organizohet si zakonisht falja e namazeve të teravisë, ku për faljen e tyre është angazhuar hoxha Iljas Veseli nga Lubini, ligjërues hoxha Shaban Tairi, ku edhe podrumi i xhamisë është i hapur për gjininë femërore që të marrin pjesë për dëgjimin e ligjëratave dhe faljen e namazeve të teravisë. Po ashtu para namazit të drekës dhe ikindisë lexohen mukabele para xhematit. Temat e ligjëratave që në fillim publikohen në hyrje të xhamisë. Këtë vit ligjëruese për gjininë femërore, ka qenë teologe Neale Osmani nga fsh. Gllumovë, e cila ka ligjëruar çdo të diele dhe të mërkure pas namazit të drekës.

Gjatë këtij Ramazani, në hyrje të derëssë xhamisë, janë montuar dy kasa për sadaka, të cilat shërbejnë për tubimin e ndihmave që japin vullnetarët për xhaminë.

Gjatë muajit të Ramazanit është ndërtuar një murë mbrojtës në parkingun e xhamisë, që të fillohet përgatitja e parkingut dhe përfundimi i projektit.

Më 17.05.2019 e premte, për namazin e xhumasë kemi pasur mysafir myftiun e Shkupit, Dr. Qenan Ismaili, i cili mbajti hutben dhe fali namazin e xhumasë.

Po ashtu, më 26.05.2019, për teravi e kemi pasur mysafir hoxhën e nderuar nga Shkupi, Llokman Kamberi, i cili ka mbajtur ligjëratë para xhematit tonë dhe ka freskuar të pranishmit me këshillat e tij të dobishme.

Në fund të muajt Ramazan, më 3.06.2019, dy hoxhallarëve u janë dorëzuar paratë që janë tubuar për ta nga xhemati, ku janë tubuar gjithësej 86.600 denarë, të cilat i kanë ndarë hoxhallarët në mes vete.Kurse për medresenë "Isa Beu", janë tubuar 45.400 denarë prej fitrave, të cilat janë dorëzuar në myftininë e Shkupit.

Me datë 18.07.2019, u përmbyll procesi i parkingut të xhamisë dhe është kompletuar për t`iu dorëzuar xhamisë në shërbim.

Toka e parkingut të xhamisë është blerë 32.000 euro, kurse dheu për mbushjen e vendit është sjellur falas. 2.200 euro është paguar për betonin për murin e parkingut, kurse 1.377 euro për material ndërtimor që është shfrytëzuar për murrin e xhamisë. Po ashtu 1.180 euro janë paguar kanaletkat dhe materialet tjera për parkingun. Hedhja e tamponit, asfaltit dhe ngjyrosja e vijave të parkingut është realizuar nga komuna e Sarajit, që ka kushtuar 20.000 euro. Janë vënduar edhe parmak për parkingun, që pjesërisht e kanë ndihmuar si projekt firma "Eftinia", kurse pjesa tjetër (900 euro) janë mbuluar nga buxheti i xhamisë.

Që nga muaji i gusht i këtij viti, nga ana e këshillit të xhamisë, është marrë iniciativë që hoxhës së xhamisë t`i rritet rroga në 25.000 denarë.

Më datë 19.10.2019, pas namazit të drekës, në xhaminë tonë është mbajtur ceremonia e hatmes nga talebet që kanë mësuar në mektebin e xhamisë tonë, te mualimi Shaban Tairi. Kjo është gjenerata e gjashtë e talebeve të mektebit tonë, ndërsa këtë rradhë kanë kryer hatme tetë talebe: Nuhi Çilafi, Aida Çilafi, Ensar Çilafi, Melik Tairi, Jasin Qaili, Fatih Jusufi, Erkan Sinani dhe Zejnebe Qaili. Në fund duanë e hatmes e bëri referenti i myftinisë Fejsal Kadriu, ndërsa myftiu Qenan Ismaili në fund mbajti një fjalim.

Në muajin nëntor të këtij viti, me inicim të këshillit të xhamisë, janë montuar katër kamera sigurimi që të mbahet rendi i xhamisë, të mos ketë dëmtime përreth apo brenda xhamisë dhe të shtohet siguria e xhamisë dhe xhematit. Blerja dhe montimi i këtyre kamerave ka kushtuar 700 euro.

Në fund të vitit, këshilli i xhamisë mbajti mbledhje të rregullt, ku në këtë tubim arkatari i xhamisë ka dhënë këtë raport: Për vitin 2019 buxheti i xhamisë ka qenë 12.362 euro, të cilat janë shfrytëzuar për:

Parkingun - 4970 euro

Parnon e xhamisë - 220 euro

Fshisa elektronike – 750 euro

Për rregullimin e mikrofonave – 450 euro

Parmak për parking – 900 euro

Kamerat e sigurimit – 700 euro

Harxhime të ndryshme – 220 euro

Për rrymë – 500 euro

Për pagesë shtesë të hoxhës – 1400 euro

Gjithësej gjatë këtij vitijanë harxhuar 10.110 euro. Buxheti i xhamisë më 28.12.2019 ka qenë 2.502 euro. Buxheti i xhamisë për dallim nga viti i kaluar, ka rritje për 52.3%.

Xhamia është duke funksionuar në mënyrë të rregullt dhe pa probleme, xhamia plotëson të gjitha nevojat e xhematit dhe shërben me aktivitete të ndryshme.

Xhamia mirëmbahet nga xhemati dhe këshilli i xhamisë, pastrohet rregullisht, parfumohet dhe lahen tepihët. Xhamia tash ka mbi 230 antarë dhe përbëhet nga rruga 6 dhe 8 në Saraj.

Shpresojmë që ky raport të pranohet me objektivizëm nga lexuesit, të shërbejë për t`iu informuar mbi zhvillimin e punës së xhamisë dhe të jetë stimulues për ardhmërinë për të zhvilluar ide të reja dhe aktivitete të dobishme.

Nëse jeni të interesuar për më shumë hollësi dhe detaje rreth aktiviteteve të xhamisë dhe financave, atëherë drejtohuni tek këshilli i xhamisë, arkatari i xhamisë, arhiva e xhamisë apo faqja zyrtare e xhamisë në facebook.

Saraj

Janar, 2020